



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerën 3,653,581€, pasi që Thesari ka ekzekutuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike joadekuate.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Podujevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Në katër raste, Komuna nuk kishte aplikuar penale për vonesat në realizimin e kontratave, ku ishin tejkaluara afatet e përcaktuara kontraktuale, nga 18 ditë deri në 74 ditë vonesë.
- B2 Komuna ka kontraktuar tri projekte kapitale në mungesë të fondeve financiare, duke i tejkaluara fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit.
- B3 Në tri raste, Komuna kishte shpërblyer me kontratë operatorët ekonomik, edhe pse nuk kishin plotësuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.
- B4 Në shtatë raste në vlerë totale prej 401,750€, faturat nuk ishin paguar me kohë duke shkaktuar vonesa nga 30 deri në 200 ditë përtej afatit ligjor.
- B5 Komuna nuk kishte mbajtur regjistrat e menaxhimit të kontratave përmes platformës së e-prokurimit.
- B6 Në 10 raste janë evidentuar vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore, duke tejkaluara afatet ligjore nga shtatë deri në 104 ditë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Podujevës.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Podujevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Podujevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Podujevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Podujevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Komuna e Podujevës në vitin 2025, ka shpenzuar 35,580,856€ apo 98% të buxhetit final. Fushat me problemet më të theksuara kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, dobësive në menaxhimin e kontratave dhe procedurave të prokurimit, inkasim i ulët i llogarive të arkëtueshme si dhe dobësive në menaxhimin e pasurive jo financiare mbi/nën 1,000€.

Procesi i raportimit në komunë është shoqëruar me mangësi, të cilat u reflektuan në përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), ku u identifikuan gabime që më pas u korrigjuan pas sugjerimeve të auditimit.

Vlen të theksohet se për vitin 2025, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 3,653,581€ përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore. Nga kjo vlerë, 2,601,921€ ishin nga investimet kapitale, 647,569€ nga mallrat dhe shërbimet si dhe 404,091€ nga subvencionet dhe transferet. Këto pagesa janë kryesisht të lidhura me kontratën kolektive.

Në total, raporti përmban 11 rekomandime, prej të cilave tri janë të reja, shtatë janë të përsëritura dhe një pjesërisht të përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas nenit 18.3 të rregullës financiare Nr. 01/2013/MF- mbi shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2025, bazuar në vendime gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa direkte në vlerë prej 3,653,581€ nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre, nga kategoria e investimeve kapitale ishin kryer pagesa në vlerë prej 2,601,921€, nga mallrat dhe shërbimet 647,569€ si dhe nga subvencione 404,091€.

Për këto pagesa, ne kemi shqyrtuar 15 mostra në vlerë totale prej 1,492,587€, prej të cilave 693,038€ ishin nga investimet kapitale, 473,502€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe 326,048€ nga subvencionet dhe transferet.

Vlen të theksohet se komuna nuk kishte përcaktuar saktësisht se sa është vlera e shpenzimeve që i përkasin borxhit kryesor për paga dhe sa e atyre përmbartimore (interes, ekspertizë, etj.).

Po ashtu, një pagesë në vlerë prej 5,380€ ishte paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve e cila për nga natyra i përket kategorisë së investimeve kapitale.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Megjithatë, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari.

**Ndikimi** Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës, duke mbivlerësuar /nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse. Po ashtu, klasifikimi jo i drejtë i shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV dhe mund të ndikon në vendimmarrjen e menaxhmentit.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Vonesat në përmbushjen e kontratave dhe mos aplikimi i penaleve

#### Gjetja

Sipas kushteve kontraktuale tek neni vonesat në ekzekutim, operatorët ekonomikë janë të obliguar të realizojnë furnizimet, shërbimet apo punët brenda afateve të përcaktuara, ndërsa në rast vonesash komuna ka të drejtë të aplikojë penalitete apo masa tjera kontraktuale. Po ashtu, në kushtet e kontratës janë përcaktuar afatet e realizimit të projekteve të kontraktuara bazuar në planin dinamik për përmbushjen e secilës kontratë.

Gjatë auditimit kemi vërejtur vonesa në realizimin e kontratave, duke tejkaluar afatet e përcaktuara kontraktuale, nga 18 ditë deri në 74 ditë vonesë. Përkundër këtyre vonesave, nuk ishin aplikuar penalitetet ndaj operatorëve ekonomik. Këto raste janë vërejtur te kontratat si në vijim:

- “Furnizim me material për radiologji” në vlerë 13,450€, prej kërkesës për furnizim deri te pranimit i faturës dhe materialit, kishte 18 ditë vonesë;
- “Furnizim me kabinete” në vlerë prej 80,000€, furnizimi do duhej të bëhej 5 ditë nga nënshkrimi i saj. Mirëpo furnizimi dhe fatura ishte bërë me datën 03.07.2025, apo 30 ditë vonesë;
- “Mirëmbajtja e lumit” në vlerë 66,735€, punët është dashur të përfundonin deri më 07.04.2025. Megjithatë, raporti i pranimit tregon se shërbimet janë realizuar me 74 ditë vonesë; dhe
- “Furnizim me aparat fotografik” në vlerë 5,000€, furnizimi do të duhej të realizohej deri më 29.09.2025, ndërsa malli është dorëzuar dhe faturuar më 20.10.2025, që tregon 21 ditë vonesë.

Po ashtu, nga testimi i kontratave për projekte kapitale dhe gjendjes në terren është konstatuar se nuk janë realizuar punët brenda afateve të përcaktuara në kontratë, duke rezultuar me realizim të ulët të punimeve dhe vonesa në përmbushjen e tyre. Këto janë vërejtur si në vijim:

- Projekti “Renovimi i teatrit” në vlerë 219,046€, ishte paraparë të përfundojë në muajin maj 2025. Megjithatë, deri shkurt në kohën e auditimit projekti ishte realizuar vetëm 79%, duke rezultuar me vonesa në realizim të punimeve;
- Projekti “Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike” në vlerë 566,649€, sipas kontratës ishte paraparë të përfundojë në muajin korrik 2025. Mirëpo, deri në shkurt në kohën e auditimit projekti ishte realizuar vetëm 55%; dhe
- Projekti “Ndërtimi i tregut të qytetit” në vlerë 1,440,787€, sipas kontratës ishte paraparë të përfundojë në muajin tetor 2025, ndërsa realizimi ishte vetëm 27% gjatë kohës sa ishim në auditim.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dobësive në menaxhimin e kontratave, mangësive në projektet teknike dhe në monitorimin jo të mjaftueshëm gjatë zbatimit të tyre. Sipas zyrtarëve, edhe mungesa së mjeteve buxhetore, e cila ka ardhur si pasojë e ekzekutimit të pagesave nga thesari për vendime gjyqësore, ka ndikuar në përmbushjen e obligimeve financiare ndaj operatorëve ekonomikë (OE), si dhe në ngadalësimin e punimeve, duke rezultuar në vonesa në realizimin e tyre.

**Ndikimi** Vonesat, mangësitë në projektet teknike dhe mos përmbushja e kontratave ndikojnë negativisht në realizimin me kohë të furnizimeve dhe punëve të planifikuara. Njëherit, mungesa e mjeteve buxhetore kanë ndikuar në pamundësinë e përmbushjes me kohë të obligimeve financiare ndaj operatorëve ekonomikë (OE), duke shkaktuar ngadalësim ose ndërprerje të punimeve. Ndërsa, mos aplikimi i penalteteve kufizon mundësinë e komunës për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga mosrespektimi i kushteve kontraktuale.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe përgatitjen e projekteve teknike cilësore, monitorim më efektiv të zbatimit të kontratave nga menaxherët përkatës si dhe buxhet të mjaftueshëm për të garantuar përmbushjen me kohë të obligimeve ndaj OE dhe realizimin e projekteve brenda afateve kontraktuale. Në të kundërtën aplikimin e penalteteve në rastet e mosrespektimit të kushteve kontraktuale.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare

**Gjetja** Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 parasheh se, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla". Po ashtu Ligji i buxhetit nr. 08/L-332 për vitin 2025, neni 12 paragrafi 7 përcakton se; "Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim".

Komuna ka kontraktuar tri projekte kapitale në mungesë të fondeve financiare, duke i tejkalluar fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit, si në vijim:

- Projekti "Ndërtimi i parkut industrial bujqësor në Sfeqël" është kontraktuar në vlerë 1,356,099€ përderisa në ligjin e buxhetit ishin planifikuar 400,000€, duke rezultuar me një tejkallim prej 956,099€.
- Projekti "Rregullimi i infrastrukturës së varrezave të qytetit" është kontraktuar në vlerë 1,150,000€ përderisa në ligjin e buxhetit ishin planifikuar 50,000€, me tejkallim prej 1,100,000€.
- Projekti "Ndërtimi i kuzhinës qendrore për fëmijë në çerdhe dhe nxënës të shkollave në Podujevë" është kontraktuar në vlerë 698,033€ ndërsa buxheti i miratuar ishte 190,000€ me një tejkallim prej 508,033€.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

**Ndikimi** Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrim i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të komunës ngase duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve dhe rrit rrezikun e kostove shtesë.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë një analizë të mirëfillë buxhetore dhe se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumatat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Shpërblimi më kontratë në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderët**

**Gjetja** Sipas nenit 59, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në tri raste, kemi vërejtur që OE ishin shpërblyer me kontratë, edhe pse nuk kishin plotësuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit. Këto raste janë vërejtur si në vijim:

- Në procedurën “Rregullimi i infrastrukturës së varrezave të qytetit”, me vlerë 1,155,000€, në dosjen e tenderit të operatorit ekonomik fitues nuk ishte ofruar dokumenti i kërkuar qarkullim vjetor i ATK-së prej jo më pak se 1,700,000 € gjatë tre viteve fiskale të fundit.
- Në procedurën “Ndërtimi i kuzhinës qendrore për fëmijë në çerdhe dhe nxënës të shkollave në Podujevë”, me vlerë 698,033 €, në vend se të ofrohej dokumenti për ISO 50001:2018 operatori fitues ka dorëzuar certifikatën PAS 99:2012, që si i tillë nuk e plotësonte këtë kriter.
- Në procedurën “Ndërtimi i parkut industrial bujqësor në Sfeqël”, me vlerë 1,356,099 €, ishte kërkuar dokumenti për ISO 9001:2015, ndërsa operatori fitues kishte dorëzuar ISO 14001:2015.

Kjo ka ndodhur si pasojë e kontrollit jo të mirë në vlerësimin e tenderëve nga ana e autoritetit kontraktues, konkretisht në verifikimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit.

**Ndikimi** Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret e përcaktura në dosjen e tenderit pengon zhvillimin e një procesi të rregullt të prokurimit, cenon transparencën, barazinë dhe efektivitetin e procesit të prokurimit publik.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuar**

**Gjetja** Neni 39.1 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në shtatë raste në vlerë totale prej 401,750€ kemi vërejtur se komuna nuk kishte paguar faturat brenda afatit ligjor. Vonesat në pagesa ishin nga 30 deri në 200 ditë përtej afatit ligjor. Këto fatura ishin prej kategorisë së investimeve kapitale 396,341€ si dhe mallrave dhe shërbimeve 5,409€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhimin e kontratave publike si dhe mungesës së buxhetit për shkak të shpenzimeve të kryera përmes vendimeve gjyqësore.

**Ndikimi** Vonesat në pagesë ndikojnë negativisht në realizimin me kohë të projekteve dhe shërbimeve, rrisin rrezikun për kosto shtesë si rezultat i padive apo kërkesave nga furnitorët dhe vështirësojnë menaxhimin efektiv të kontratave.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të forcojë kontrollet në planifikimin dhe menaxhimin e mjeteve buxhetore, në mënyrë që obligimet financiare të përmbushen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe sigurimit të fondeve të mjaftueshme para marrjes së obligimeve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B5 - Regjistri i menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit**

**Gjetja** Paragrafi 70.24.f i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh që menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën përkatës në sistemin e prokurimit elektronik.

Menaxherët e kontratave/projekteve edhe këtë vit, nuk i kanë mbajtur dhe arkivuar përmes platformës së e-Prokurimit menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve. Këto janë vërejtur nga testimi i procedurave të përzgjedhura të prokurimit në tri raste me vlerë të përbashkët prej 2,166,992€, Planet për Menaxhimin e Kontratës (PMK) nuk ishin të bashkëngjitura në sistemin e e-Prokurimit. Ndërsa në dy raste tjera në vlerë 54,257€ PMK ekzistojnë mirëpo ato nuk ishin të nënshkruara nga të dy palët si dhe në një rast në vlerë 117,976€ PMK nuk ishte nënshkruar nga operatori ekonomik.

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i dështimeve të menaxherëve të kontratave për t'i menaxhuar kontratat përmes sistemit të e-prokurimit dhe mungesës së monitorimit nga autoriteti kontraktues në procesin e përgatitjes, finalizimit dhe ngarkimit të dokumenteve për menaxhimin e

kontratave në sistemin e e-prokurimit

**Ndikimi** Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të përgatisin, nënshkruajnë dhe ngarkojnë planet për menaxhimin e kontratave në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe të forcojnë mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit për të garantuar zbatimin e plotë të kërkesave ligjore në menaxhimin e kontratave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B6 - Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore**

**Gjetja** Neni 17 (pika 1.2) i Ligjit Nr. 04/L - 110 për Ndërtim përcakton se leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III.

Gjatë vitit 2025, Komuna ka lëshuar gjithsej 19 leje ndërtimore. Megjithatë, në 10 raste janë evidentuar vonesa në lëshimin e tyre, duke tejkaluar afatet ligjore nga shtatë deri në 104 ditë. Sipas kategorive, vonesat janë paraqitur si në vijim.

- Për kategorinë I, vonesat varionin nga shtatë deri në 17 ditë;
- Për kategorinë II, vonesat ishin më të theksuara, nga 48 deri në 104 ditë.

Vlera totale e këtyre mostrave është 180,540€.

Këto vonesa janë shkaktuar kryesisht nga mos respektimi i kornizës ligjore dhe mos funksionimi i kontrolleve të brendshme për shqyrtimin dhe trajtimin me kohë të kërkesave për lejet ndërtimore.

**Ndikimi** Vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore ndikojnë negativisht në arkëtimin me kohë të të hyrave komunale nga këto leje. Po ashtu, ato vonojnë fillimin e aktiviteteve ndërtimore dhe zhvillimore të bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë respektimin e afateve ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, forcimin e kontrolleve në procesin e pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit dhe të rris efikasitetin në trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,395,811€, prej tyre ishin shpenzuar 9,841,928€ apo 95%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, objekteve arsimore, ndërtesa administrative, shpenzime të vendimeve gjyqësore etj.

#### Çështja A2 - Përdorimi i procedurës së negociuar të prokurimit pa plotësimin e kushteve

##### Gjetja

Sipas nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë mund të përdoret vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, si urgjenca ekstreme që nuk mund të parashikohet dhe që nuk është shkaktuar nga vetë autoriteti kontraktues.

Komuna e Podujevës kishte lidhur kontratë për projektin “Ndërtimi i vend parkimit të autobusëve” në vlerë prej 6,997€ në janar 2025. Procedura e prokurimit ishte iniciuar në muajin dhjetor 2024, duke përdorur procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Megjithatë ky arsyetim nuk e justifikon përdorimin e kësaj procedure, pasi nuk plotësohen kushtet për urgjencë ekstreme të parashikueshme, siç kërkohet me legjislacionin e prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësisë në planifikimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit.

##### Ndikimi

Përdorimi i procedurave jo konkurruese mund të ndikojë në transparencën dhe të çojë në hyrjen të obligimeve të cilat nuk kanë mbulueshmëri buxhetore.

##### Rekomandimi A2

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret vetëm në rastet kur plotësohen në mënyrë të qartë kushtet ligjore për urgjencë ekstreme të parashikueshme, duke garantuar transparencë dhe konkurrencë në proceset e prokurimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 117,943,403€, pasurive jokapitale është 3,315,483€, si dhe e stoqeve 91,002€.

### Çështja B7 - Nënvlërësimi i regjistrave të pasurisë në PFV

#### Gjetja

Sipas Rregullorja Financiare MF Nr. 02/2013, neni 3 përcakton se Regjistri i Përgjithshëm i Pasurive duhet të jetë një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive jo financiare, e cila azhurnohet rregullisht dhe mbështet raportimin në pasqyrat financiare. Ndërsa neni 6 kërkon që regjistri të përmbajë të gjitha elementet relevante, si: emrin e organizatës, përshkrimin e pasurisë, numrin serik, barkodin, datën e pranimit, lokacionin, kategorinë, burimin e financimit dhe zhvlerësimin.

Nga auditimi është konstatuar se:

- Nëntë pasuri të blera gjatë vitit 2025 në vlerë të përbashkët 178,434 nuk janë regjistruar në SIMFK dhe në sistemin e e-pasurisë, duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë në Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV).
- Gjithashtu, në aneksin e PFV-së, pasuritë jo kapitale në vlerë prej 3,315,483€ janë paraqitur në mënyrë të agreguar dhe pa aplikuar zhvlerësimin përkatës, duke rezultuar në mbivlerësim të pasurive nën 1,000€. Për shkak të shënimeve jo të plota dhe numrit të madh të aseteve, auditori nuk ka mundur të përcaktojë saktë vlerën financiare të.

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme, përfshirë mungesën e një zyrtari përgjegjës për menaxhimin e pasurisë dhe regjistrimin me kohë të saj.

#### Ndikimi

Mungesa e zyrtarit të pasurive si dhe mos regjistrimi i pasurive sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare ndikon në raportim jo të saktë të vlerës së pasurive, duke rezultuar në nënvlerësim/mbivlerësim dhe prezantim jo të drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore.

#### Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë rekrutimin e zyrtarit të pasurisë, si dhe të garantojë regjistrimin e saktë dhe të plotë të pasurisë jo financiare, si kapitale ashtu edhe jo kapitale, në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Të arkëtueshmet

OB-ja në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arketueshme në vlerë prej 4,091,930€.

#### Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

##### Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritet për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që tejkalojnë shumën prej 10€. Ndërsa, sipas nenit 27 të këtij ligji, në rast se tatimpaguesi nuk i shlyen detyrimet tatimore dhe eventualisht gjobat brenda afateve të përcaktuara, komuna është e obliguar të lëshojë njoftim përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune nga dita e fundit e pagesës, duke kërkuar shlyerjen e plotë të detyrimeve brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga pranimi i njoftimit. Po ashtu, arkëtimi i të hyrave tjera duhet të realizohet në përputhje me afatet e përcaktuara në faturat dhe kontratat përkatëse.

Gjatë vitit aktual, komuna ka arritur të zvogëlojë nivelin e llogarive të arkëtueshme nga 5,750,975€ në 4,091,930€ për 1,659,045€, respektivisht rreth 28.85% krahasuar me vitin 2024. Ky progres tregon se janë ndërmarrë veprime në drejtim të përmirësimit të arkëtimit, veçanërisht në fushën e tatimit në pronë (nga 4,592,068€ në 2,962,626€ në vitin 2025). Megjithatë, niveli i përgjithshëm i llogarive të arkëtueshme mbetet ende i lartë.

Struktura e llogarive të arkëtueshme dominohet nga tatimi në pronë në vlerë prej 2,962,625€, e ndjekur nga qiratë komunale në shumën prej 1,113,653€, tarifatat për shfrytëzimin e hapësirave publike në vlerë prej 12,715€, si dhe të tjera në vlerë prej 2,936€.

Dobësitë e identifikuar lidhen kryesisht me mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm, veçanërisht në menaxhimin dhe arkëtimin efektiv të llogarive të arkëtueshme, përfshirë mungesën e mekanizmave të mjaftueshëm për monitorimin dhe ndjekjen e tyre.

##### Ndikimi

Dobësitë e identifikuar lidhen kryesisht me mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm, veçanërisht në menaxhimin dhe arkëtimin efektiv të llogarive të arkëtueshme, përfshirë mungesën e mekanizmave të mjaftueshëm për monitorimin dhe ndjekjen e tyre.

##### Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e mëtejshëm të procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2025, ishte 1,270,244€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2026.

### Çështja A3 - Dobësi në raportimin e obligimeve në Thesar

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare Nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore, neni 5, organizatat buxhetore duhet të raportojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjitha obligimet e papaguara në raportet mujore të obligimeve që dorëzohen në Thesar.

Gjatë auditimit është konstatuar se dy fatura në vlerë të përbashkët prej 11,495€ nuk janë raportuar në raportet mujore të obligimeve të papaguara të dërguara në thesar.

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i kontrolleve të brendshme joefektive në procesin e regjistrimit dhe raportimit të obligimeve financiare.

**Ndikimi** Mosraportimi i plotë i obligimeve financiare rrit rrezikun që obligimet e papaguara të mos paraqiten saktë në raportet financiare dhe mund të ndikojë në menaxhimin dhe planifikimin e buxhetit.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha obligimet financiare të regjistrohen dhe raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në raportet mujore të dërguara në Thesar, përmes forcimit të kontrolleve të brendshme dhe verifikimit sistematik të këtyre raporteve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

#### Çështja 1

#### Gabimet e identifikuar në prezantimin e PFV

##### Gjetja

Gjatë rishikimit të pasqyrave financiare vjetore u identifikuan disa mospërputhje dhe prezantime jo të sakta si:

- Te Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit te kolona e parë Realizimi- Të Hyrat e dedikuara vlera e prezantuar prej 1,055€ është kërkuar të zhvendoset tek kolona e njëjtë tek të hyrat tjera. Po ashtu tek kolona e Buxhetit final tek Grantet e përcaktuara të donatorëve nuk është paraqitur vlere e tyre prej 146,404€.
- Te neni 14.6 tek kolona Të hyrat vetanake Komuna ka paraqitur të hyrat tatimore, të hyrat jo tatimore dhe të hyrat e dedikuara në vlerë 2,149,851€, të cilat nuk ka nevojë të paraqiten. Kurse tek kolona Buxheti përfundimtar SIMFK tek Hyrjet duhet të ishte e barabartë me kolonë B tek neni 14.
- Tek shpalosjet e detyrimeve kontigjente është kërkuar që vlere prej 412,275€ të largohen nga lista, pasi lëndët ishin mbyllur/fituar dhe duhej të ishin pjesë e obligimeve të papaguara.

##### Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korrigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

##### Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime korrigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korrigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PFV e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit

### 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>33,459,115</b>	<b>36,448,751</b>	<b>35,580,856</b>	<b>33,438,552</b>	<b>29,739,731</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	31,472,779	33,025,953	33,002,933	30,627,653	27,799,690
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	178,730	88,130	46,720	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	890,001	804,650	1,041,660	610,627
Të hyrat vetanake	1,986,336	1,986,336	1,446,195	1,445,343	1,214,331
Donacionet vendore	0	367,209	238,948	277,177	115,083
Donacionet e jashtme	0	522	0	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,989,636€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të Qeverisë, të hyrave të bartura nga viti i kaluar, klauzolës së investimeve si dhe donacioneve.

Komuna ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 35,580,856€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2025, Komunës i janë ekzekutuar pagesa përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 3.6€ milion nga kategori të ndryshme ekonomike.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>33,459,115</b>	<b>36,448,751</b>	<b>35,580,856</b>	<b>33,438,552</b>	<b>29,739,731</b>
Pagat dhe mëditjet	17,669,041	19,222,217	19,205,159	18,187,621	16,110,409
Mallrat dhe shërbimet	4,090,032	4,097,234	4,062,325	3,412,938	3,142,048
Komunalitë	633,600	633,600	633,600	548,117	465,147
Subvencionet dhe transferet	1,810,000	2,099,889	1,837,845	1,975,239	1,554,054
Investimet Kapitale	9,256,442	10,395,811	9,841,928	9,314,637	8,468,073

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,533,176€. Rritja ishte bërë me vendimet e Qeverisë, ndërsa realizimi ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 7,202€ si rezultat i donacioneve. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti fillestar, buxheti final si dhe shpenzimet në kategorinë e komunalive ishte 633,600€ apo 100%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 289,889€ si rezultat i donacioneve. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 88%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,139,369€. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave të bartura, donacioneve dhe klauzolës së investimeve. Realizimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale ishte 95%, ku në këtë realizim reflekton edhe shuma e shpenzimeve përmes vendimeve gjyqësore të kryera për pagat jubilarë të shkaktuara nga kontrata kolektive.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2025, ishin vlerë prej 1,986,336€, ndërsa ishin realizuar 2,149,851€. Këto të hyra përfshijnë të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 652,325€, si dhe të hyra nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës në vlerë 166€. Këto të hyra i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,986,336</b>	<b>1,986,336</b>	<b>2,149,851</b>	<b>1,710,894</b>	<b>1,740,942</b>
Të hyrat tatimore	774,542	774,542	574,315	347,163	666,373
Të hyrat jo tatimore	1,211,794	1,211,794	1,574,481	1,363,731	1,074,569
Të hyrat tjera	0	0	1,055		

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar me 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, ne kemi identifikuar se pesë rekomandime ishin zbatuar, një rekomandim pjesërisht i zbatuar dhe shtatë rekomandime ishin përsëritur siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave.	Kemi identifikuar probleme të natyrës së njejtë edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.	Nga testimi i mostrave të përzgjedhura, janë identifikuar raste të natyrës së tillë	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.	Nga testimi i mostrave të përzgjedhura, janë identifikuar raste të natyrës së tillë.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestিনি i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.	Edhe në vitin 2025 komuna kishte keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Në vitin 2025 Kryetari kishte raportuar.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se financat dhe zyra e prokurimit do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Rekomandimi është zbatuar dhe janë ndërmarrë veprime për zbatimin e Rregullës Financiare në procedimin e pagesave.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e procedurave për menaxhimin e fondeve, duke siguruar që çdo transferim i fondeve nga një projekt në tjetrin të miratohet paraprakisht nga Kuvendi Komunal.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar

9.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Nuk kemi identifikuar rasta të tilla.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.	Për vitin 2025 ishte kryer inventarizimi sipas legjislacionit në fuqi.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale dhe jo kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Edhe këtë vit kemi identifikuar probleme të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.	Komuna kishte ndërmarr disa hapa sa i përket arkëtimit të të hyrave nga tatimi në pronë, mirëpo ende kemi nivel të lartë të LLA.	Pjesërisht i zbatuar
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Pavarësisht veprimeve të ndërmarra, rekomandimi nuk është zbatuar, pasi vonesat në pagesën e faturave vazhdojnë të përsëriten.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIK OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
KODI I IDENTIFIKIMIT: 04-47-811-1			
Nr. Prot. / Prot. No. 20-05-2026			
04	47	811	1

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIK OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS - MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADR - DRPANA ADMINISTRACIJE		
Datë / Date	20.05.2026	
Nr. / No.	02-052/19-0024350/26	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Podujevës**  
**Opština Podujevo - Municipality of Podujeva**



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Podujevës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Shpejtim Balliu

Kryetar i Komitit të Podujevës

Data: 19.maj.2026, Podujevë



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.